



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Pridato Received/Delivery	05-02	4	viti god year
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	686/2024		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1557/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1557/2023 të datës 21.12.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me Nr.01/XII/2023 të datës 14.12.2023 të protokolluar më datë 15.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.02.2024, mori këtë:

### V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1557/2023 e datës 21.12.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.01/XII/2023 i datës 14.12.2023 i protokolluar më datë 15.12.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 15.05.2018 në pozitën *Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softverike* në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 17.11.2023 u.d Udhëheqësi i Departamentit të SISH, ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore për shkelje disiplinore të paraqitura sipas emailit të datës 26.10.2023 dhe 30.10.2023 dhe atë për: 1. Mos respektim i orarit të punës; 2. Vizita dhe dalje nga puna pa paralajmërim dhe duke mos njoftuar Menaxhmentin apo Stafin e SISH për veprimtarinë e tij; 3. Mungesë e disiplinës në punë veprim i përsëritshme shumë herë nga i njëjti dhe 4. Mungesë



*profesionalizmi në aktivitet primare të tij për të cilat veprime të tij kanë shkaktuar edhe dëme të riparueshme në proces. Duke kërkuar që i njëjti të transferohet nga DSISH në një departament ose njësi tjetër për të paktën 1 vit sipas legjislacionit në fuqi, pasi i njëjti nuk është kompetent për punë profesionale në këtë departamenti duke parë veprimet e të njëjtit tashme kam kërkuar që ti ndalohen të gjitha qasjet në infrastrukture kritike me çka bazuar në vlerësimin tim profesional i njëjti nuk mund të vazhdoj punën në kuadër të kësaj pozite pas veprimeve të një pas njëshme. Duke qenë se i njëjti edhe përkundër shume vërejtjeve nuk ka gjetur mundin të përmirësohet në cilësinë e menaxherit nuk mund të marr asnjë përgjegjësi për veprimet e tij të pakontrolluara.*

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, më datë 14.12.2023 ka nxjerr Vendim me Nr.01/XII/2023 të protokolluar më datë 15.12.2023, përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i tridhjetë (30) përqind të pagës bazë për një periudhë prej katër (4) muaj".

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.01/XII/2023 të datës 14.12.2023 të protokolluar më datë 15.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, më datë 21.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7596/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.12.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërsa Këshilli më datë 29.12.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7596/2023 të datës 21.12.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.01/XII/2023 të datës 14.12.2023 të protokolluar më datë 15.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë; Emailin e datës 20.10.2023 nga ankuesi për F.Sh; Emailin e datës 20.10.2023 nga F.Sh për ankuesin; Emailin e datës 20.10.2023 nga ankuesi për K.Sh; Emailin e datës 19.10.2023 nga K.Sh për ankuesin; Emailin e datës 10.10.2023 nga F.Sh për Z.H, M.D dhe K.Sh; Emailin e datës 10.10.2023 nga ankuesi për F.Sh; Emailin e datës 10.10.2023, 09.10.2023 nga ankuesi për F.Sh; Emailin e datës 09.10.2023 nga F.Sh për Z.H; Emailin e datës 06.10.2023 nga ankuesi për F.Sh, A.S-H dhe K.Sh; Emailin e datës 05.10.2023 nga F.Sh për A.S-H dhe K.Sh; Sistemin elektronik të lëndëve ligjore; Emailin e datës 30.10.2023 nga ankuesi për Z.H, H.S dhe J.G; Emailin e datës 30.10.2023 nga Z.H për H.S dhe J.G; Raporti i prezencës në punë për periudhën 01.04.2023 deri 27.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.12.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 29.12.2023; Akt Emërimit e datës 15.05.2018; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 17.11.2023 së bashku me emailin e datës 26.12.2023; Screenshot nga serveri i databazës; Emailin e datës 20.11.2023 nga J.G për H.S dhe K.B; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 07.12.2023.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit), pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.01/XII/2023 të datës 14.12.2023 të protokolluar më datë 15.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, pretendon se në këtë rast nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike sepse nuk është argumentuar nëse janë fshirë lëndët siç pretendohet.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji mori për bazë: Nenin 55, i cili përcakton: "1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën; ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim", Nenin 56, ku përcaktohet: "1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; 4.13. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi".





Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe provave materiale të lëndës, konstaton se znj. F.Sh e cila mban pozitën Zyrtare e Lartë Ligjore pranë Departamentit Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë përmes emailit të datës 05.10.2023 ku ka qenë i njoftuar edhe ankuesi njofton që sipas informatave të zyrtarit përgjegjës për sistemin elektronik të lëndëve të gjykatës gjatë disa ndryshimeve të bëra në sistem më nuk figuron dokumentacioni i regjistruar nga viti 2016 deri në vitin 2023, ndërsa ankuesi përmes emailit të datës 06.10.2023 njofton znj. F.Sh, se dokumentacioni është kthyer në sistem dhe është i gatshëm për përdorim, por znj. F.Sh njofton përmes emailit të datës 09.10.2023 se sistemi elektronik nuk hapet fare, ndër të tjera përmes emailit të datës 10.10.2023 njofton ankuesin se vetëm gjashtë (6) lëndë figurojnë në sistem dhe lëndët e tjera mungojnë. Në lidhje me këtë proces, Kolegji i Këshillit, konstaton se dokumentacioni i regjistruar nga viti 2016 deri në vitin 2023 me të dhënat për lëndët gjyqësore të Departamentit Ligjor është fshirë dhe nuk ekziston, kjo mund të konstatohet sipas shkresave të lëndës, gjegjësisht emailit të datës 30.10.2023 të dërguar nga Z.H për ankuesin i cili ka theksuar se: *“në lidhje me këtë dokument me duhet të sqaroj se sikur në fillim të kishte elaboruar këtë problem teknik se çfarë ka mund të ketë ndodhur si pasojë e ndonjë gabimi teknik nuk do të mund të ishim në këtë pikë ku jemi tani, mirëpo ashtu siç edhe keni thënë ka mund të ndodhë dhe ka ndodh një gabim teknik i cili kishte një efekt fshirje”,* ndërsa ankuesi përmes emailit të datës 30.10.2023 njofton Z.H, se: *“Problemet teknike ishin shfaqur pas kërkesës për përditësim respektivisht zhvillimit dhe pasi ato janë paparashikueshme unë nuk mund të identifikoj gabimet që do të shfaqeshin por vetëm ato të ishin në zhvillim e sipër. Pra gjatë kësaj procesi të mirëmbajtjes dhe testimit nuk e përjashtoj mundësim që ato shënime të ishin fshirë ose të ishin zhvendosur në kolonën e re. Nuk më kujtohet sakt por e di që me është dashur ti largoj tabelat përkohësisht në mënyrë që të zëvendësohen me tableta nga Backup. Mandej pasi është krijuara databaza 2 dhe është kthyer Backup nuk kam shikuar në databazën kryesore q por vetëm në databazën 2 dhe me tableta që ishin inportuar nga backup në databazën 2”.*

Nga shkresat e lëndës dhe komunikimet si pjesë e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se vetë ankuesi përmes komunikimeve e pranon se lëndët kanë mundur të jenë fshirë, kështu nga shkresat tjera të lëndës është konstatuar se dokumentacioni i regjistruar nga viti 2016 deri në vitin 2023 me të dhëna për lëndët gjyqësore të Departamentit Ligjor nuk ekzistojnë dhe janë fshirë dhe për këtë ankuesi nuk ka njoftuar mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë, si rezultat i këtyre veprimeve apo mos veprimet ankuesi ka vepruar në kundërshtim me përshkrimin e detyrave të punës, ka bërë shkelje disiplinore të parapara me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që sipas nenit 55 paragrafi, të këtij ligji është përcaktuar se: *“1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me Nr.01/XII/2023 të datës 14.12.2023 të protokolluar më datë 15.12.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, konstaton se ky komision në mënyrë të drejtë ka cilësuar shkeljen e bërë nga ankuesi dhe në mënyrë të drejtë ka



shqiptuar masën disiplinore duke vepruar në pajtim me nenin 55 paragrafi 1, nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.5, nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, nenin 58 paragrafi 2, nenin 61 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitat të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, për rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji i Këshillit, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1557/2023, datë 05/02/2024

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;